

BARDHYL DEMIRAJ

NJË PËRDORIM I VEÇANTË I MBIEMRAVE PREJNUMËRORË

Në studimet gjuhësore përshkruese të derisotme, në gramatikat dhe në doracakët e gjuhës shqipe, si edhe në tekstet e ndryshme shkollore, është pranuar përgjithësisht se mbiemrat prejnumërорë: *i dytë, i tretë, i katërt* etj., si mbiemra cilësorë të ndërmjetuar, pasqyrojnë marrëdhënien e një sendi me një numër, duke treguar për çdo rast rendin e tij ndaj sendeve të tjera të të njëjtit lloj. Kjo marrëdhënie përfaqëson përbërësin kuptimor kryesor në tërësinë e kuptimeve të njoitura për mbiemrat në shqyrtim në fjalorët e ndryshëm shpjegues të gjuhës shqipe, p.sh.: *radha e tretë, java e katërt, muaji i nëntë, plani i gjashtë pesëvjeçar* etj.; e dorës së dytë, zë *i dytë, violinë e dytë, biletë e klasës së tretë, bimë* të dyta etj.; *baba (nënë, motër, vëlla)* i dytë, *iu bë natyrë e dytë; s'ka të dytë* etj.

Shënim i rendit si veçori tipike dhe e qëndrueshme e kësaj kategorie fjalësh ka kushtëzuar edhe emërtimin e tyre tradicional *numërorë* (*mbiemra*) *rreshtorë* e bashkë me të edhe trajtimin e vëçantë gjuhësor brenda kategorisë leksiko-gramatikore të numëro-rëve¹.

Megjithatë, në gjuhën shqipe dallohen edhe disa raste kur këta mbiemra nuk shënojnë rendin, por njëloj si numërorët (themelorë) mbartin nocione të vëçanta që lidhen me numrat matematikë, trajtojnë një sasi të caktuar, duke dalluar qartë një numër nga numrat e tjerë. Është fjala këtu për një përdorim të këtyre mbiemrave, kur dalin si gjymtyrë të shprehjeve thyesore ose të ndonjë togu të qëndrueshëm.

Sic dihet, thyesat, njëloj si numërorët (themelorë), shënojnë numra, veçse këta nuk jepen me njësi të plota, por me pjesë të një ose disa njësive². Nga mënyra e formimit, thyesat paraqiten të gjitha si shprehje të përbëra nga një numër i plotë abstrakt dhe një mbiemër prejnumëror i emëruar në gjininë femërore: *një e pesta* (1/5), *tre të katërtat* (3/4), *pesë të tetat* (5/8), *nëntë të dhjetat* (9/10) etj. Te këto shprehje, mbiemri prejnumëror shënon një tërësi të ndarë në një numër pjesësh, kurse numërori (themelor) shënon disa pjesë të caktuara të kësaj tërësie. Kështu p.sh., thyesa *tre të katërtat* (3/4) tregon se çdo njësi është ndarë në katër pjesë të barabarta dhe prej tyre janë marrë tri pjesë. Sic shihet, në shprehjet thyesore mbiemri prejnumëror, i emëruar, nuk shënon radhën e sendeve a të dukurive të ndryshme, por tregon një sasi të caktuar, një tërësi ose bashkësi pjesësh të barabarta.

Këta mbiemra dalin me një funksion deri diku të ngjashëm edhe kur janë përbërës të togjeve të qëndrueshme të tipit *vetë i tretë, vetë i pestë, vetë i dhjetë* «Tre, pesë, dhjetë veta së bashku»³. Në këto sintagma mbiemri prejnumëror shënon një sasi të

-
- 1) Me përgjashtim të veprës «Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe», II, Tiranë, 1976, në të gjitha studimet e mëparshme gjuhësore kjo kategori mbiemrash është dalluar me termin *numëror* (*mbiemrë*) *rreshtor*, duke u trajtuar në përgjithësi veças, brenda klasës së numërorëve të mirëfilltë.
 - 2) Shih: «Fonetika», *vep. e cit.*, kreu «Numërori», f. 167.
 - 3) Me këtë kuptim, kjo njësi frazeologjike është shënuar edhe në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe», Tiranë, 1980, f. 397.

caktuar njerëzish, ndërsa përemri vvetë përfaqëson në përgjithësi subjektin logjik të gjithë kumtimit, personin kryesor që e mbyll këtë tërësi¹: ...po me vete ligjërova, sikur t'ishja vet'i dytë (N. Hakiu, Zëri i fyellit, 1959, f. 35); *Thonë, është vët-i-tretë*, /*Thonë, është vët-i-tretë*, /*Thonë vët-i-injëstetë*, (*Rrofsh moj Shqipëri përjetë*) (L. Poradeci, Ylli i zemrës, 1937, f. 26); ... e shkoi vëtë i shtati tu mbreti (Prralla kombëtare, I, 1942, f. 25); *Ishte vët i tretë, po karabinierët ishin një kope* (Sh. Musaraj, Para agimit, 1965, f. 110) etj. Pra, edhe në këto raste, funksioni i mbiemrit prejnumëror është që të pohojë praninë e një tërësie të përfunduar, duke vënë në dukje se sa të tjerë së bashku me subjektin janë të nevojshëm për ta plotësuar atë².

Sic shihet edhe nga sa u parashtrua këtu më sipër, mbiemrat prejnumërorë ose të ashtuquajturit numërorë (mbiemra) rreshtorë nuk funksionojnë vetëm si shënjues të rendit, por edhe për të treguar një sasi të caktuar, një bashkësi numrash, sendesh ose dukurish të një fare që veprojnë si një e tërë e vëtme.

* * *

Vënia në dukje e këtij funksioni për mbiemrat në shqyrtim paraqet interes në disa anë të studimit të gjuhës shqipe.

Nga pikëpamja gjuhësore përshkruese merr rëndësi të veçantë zgjerimi i vëllimit kuptimor të këtyre mbiemrave, i cili mendojmë se duhet të gjejë pasqyrim të plotë edhe në fjalorët shpjegues dhe në gramatikat e gjuhës shqipe. Ky funksion e rrit edhe më tej përparësinë e termit *mbiemra prejnumërorë*³, përkundrejt termave tradicionalë *numërorë rreshtorë* dhe *mbiemra rreshtorë*.

-
- 1) K. Cipo në «Gramatika e shqipes», Tiranë, f. 90 shkruan se «numërorët rreshtorë që plotësojnë përemrin *vëtë* të gojnë radhën e emrit që përfill përemri *vëtë*».
 - 2) Njësitë frazeologjike të këtij tipi parakuptojnë barabar një tërësi të caktuar njerëzish. Por, në varësi nga rrethanat e ligjërimit, del më shumë në pah, sipas rastit, herë subjekti i veçuar nga tërësia e dhënë, herë tërësia brenda së cilës bën pjesë edhe subjekti. Krahaso për këtë qëllim dy shembujt e mëposhtëm: a) *S'të gënjej, më placin sytë/ ai ndodhet vët i dytë* (N. Hakiu, Zëri i fyellit, 1979, f. 20); b) *E sa kish dalë gjethi, ata kishin pasë ikë vëtë i dymbëdhjetë..*
 - 3) Shih: «Fonetika», vep. e cit., f. 130, 175.

Një vend të rëndësishërm zë ky funksion gjatë hulumtimeve gjuhësore historike në fushë të shqipes. Sintagmat e ngulitura: *një e dyta, tri të katërtat, tetë të dhjetat* etj.; *vetë i tretë, vetë i gjashtë* etj., përfaqësojnë gjurmët e fundit të funksionit burimor të mbiemrave prejnumërорë indoевropianë. Në shkencën e indoevropianistikës është vërtetuar tashmë se mbiemrat prejnumërорë në zanafillë dilnin me një funksion «integrues», «plotësues», duke shënuar përgjithësisht elementin e një serie numerike që e përfundon, e plotëson atë si termi i fundit i saj¹, ndërsa shënimi i radhës është një zhvillim kuptimor indoevropian i mëvonshëm². Ky përdorim i mbiemrave prejnumërорë është ruajtur në gjuhë indoevropiane, të vjetra e të reja, dhe në të gjitha, sikurse në shqipe, është i kushtëzuar tashmë brenda kufijve të një sintagme të ngulitur, ku bëjnë pjesë mbiemri në shqyrtim dhe një fjalë tjeter për «vetë», p.sh., në indishten dhe në greqishten e vjetër, në gjermanisht, në sllavishten dhe në frëngjishten e vjetër, në italishtet etj.³ Ky bashkëpërkim i shqipes me gjuhët e tjera indoevropiane mbështet më së miri mendimin se funksioni «integrues» «plotësues» i mbiemrave prejnumërорë është një dukuri tjeter e trashëguar e kësaj gjuhe, duke u renditur kështu përkrah simotrave të saj indoevropiane.

-
- 1) Shih E. Benveniste, «Noms d'agent et noms d'action en indo-européen», Paris, 1948, f. 158.
 - 2) Ky zhvillim kuptimor lidhet me ndryshimin e konceptimit psikik të numrit te mbartësit e hershëm të indoevropianishtes së lashtë. Nga një numër-bashkësi, një tërësi e mbyllur, ai u zëvendësua me numrin «e hapur», si pjesë përbërëse e serisë së pafund të numrit. Shih E. Benveniste, *vep. e cit.*, f. 160.
 - 3) Shih C. Watkins, *Notes on celtic and i.e. morphology and syntax*, në «Lochlann», III, f. 293 v.